



01-3UG

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	
---	--	---

Në bazë të nenit 21, 22 44 dhe 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-0287150/17 dt. 22.11.2017, të pronarit Ibrahim Llumnica Bekim Ferizi dhe Afrim Ferizi nga Prishtina dhe investitorit investitor “Alb Vizon Construction” Sh.p.k. dega në Kosove, me përfaqësues Simon Marku nga Puka, R. E Shqipërisë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+5ET+NK ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 23.01.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Ibrahim Llumnica, Bekim Ferizi dhe Afrim Ferizi sipas dëshmisë së pronësisë nga Prishtina, me investitor “Alb Vizon Construction” Sh.p.k. dega në Kosove, me përfaqësues Simon Marku, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810792996, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-0287150/17 dt. 22.11.2017, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+5ET+NK, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-31830 dt. 22.04.2010, e lëshuar nga kjo Drejtori në emër të Ibrahim Llumnica në kuadër të bllokut urban “A18 dhe A19” të tërësisë urbane “A” të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 01713-0, ZK Matičan, me qasje në rrugën “Ndue Perllëshi”.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-31830 dt. 22.04.2010, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të komisionit profesional të pranimit teknik të ndërtesës, nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj certifikate.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të saja në evidencat e regjistrimit kadastral.

A r s y e t i m

Aplikuesit/pronarët Ibrahim Llumnica, Bekim Ferizi dhe Afrim Ferizi nga Prishtina dhe investitori “Alb Vizon Construction” Sh.p.k. dega në Kosove, me përfaqësues Simon Marku nga Puka, R. E Shqipërisë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810792996, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-0287150/17 dt. 22.11.2017, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën



shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+5ET+NK, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban "A18 dhe A19" të tërësisë urbane "A" të Planit Rregullues "Mati 1", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1713-0, ZK Matičan, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351-31830 dt. 22.04.2010, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Aplikuesit me kërkesën, 05 Nr. 391/02-0287150/12 të datës 22.11.2017 dhe 05 Nr. 391/02-202974/22 të datës 23.08.2022 kanë prezantuar:

- Aktvendimin me numër 05 Nr. 351-31830 dt. 22.04.2010 për Lejimin e Ndërtimit të ndërtesës afariste me etazhitet B+S+P+5ET+NK të pronarëve Ibrahim Llumnica, Bekim Ferizi dhe Afrim Ferizi me investitor "Alb Vizon Construction" Sh.p.k. dega në Kosove, me përfaqësues Simon Marku nga Puka, R. E Shqipërisë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810792996 në kuadër të ngastrës kadastrale nr. 01713-0-0, Zona Kadastrale Matičan, në Lagjen "Mati 1".
- Aktvendimi nr. 05 Nr. 351-31830 dt. 15.12.2009 mbi kompensimin për rregullimin e tokës ndërtimore,
- Lejen Urbanistike nr. 05 Nr. 350-22087 dt. 18.08.2009 mbi kushtet tekniko-urbanistike për ndërtimin e objektit investiv në ngastrën kadastrale 01713-0 (si rezultat i basahkimit të parcelave 680 me parcela tjera) Zona Kadastrale Matičan, në Lagjen "Mati 1".
- Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të ndërtesës nga komisioni profesional i emëruar nga kjo Drejtoria sipas Vendimit me numër 05-351-30589/17 të datës 20.03.2017.
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografji gjatë procesit të ndërtimit,

Kjo drejtoria, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Me kërkesën numër 05-391/02-202974/22 të datës 23.08.2022 për plotësim lënde kanë prezantuar kopjen e planit dhe fletën poseduese me destinim të shfrytëzimit si tokë ndërtimore.

Ndërsa, në raportin e komisionit profesional për pranimin teknik të ndërtesës është konstatuar se pranohet si objekt funksional, teknikisht i rregulluar, me siguri në stabilitet dhe performancë të shkëlqyer;

- Sipas nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, dhe dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110 janë plotësuar organi kompetent lëshon certifikatën të përdorimit brenda kohës së caktuar;

Andaj, kjo drejtoria, duke u bazuar në konstatimet e lartshënuara, dhe duke vepruar konform nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat ligjore të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, si dhe në raportin e komisionit për pranim teknik, konstatoi se ndërtesa shumë banesore me afarizëm me etazhitet B+S+P+5ET+NK, mund të përdoret, përkatësisht vendosi të lëshojë Certifikatën e Përdorimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtoria, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI



Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-0287150/17 DT. 23.01.2024

Zyrtari,
Berim Osmanaj

Udhëheqëse e sektorit
Gazila Klisaj



